



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC


Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odhajenje za Opštu Upravu



-III- Nr. l prot. 1420 Më 05.04.2023
Br. prot. DL
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORTI 3 MUJOR I PUNËS

JANAR, SHKURT DHE MARS 2023



2023

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike gjatë 3 MUJORIT të parë të vitit 2023

- Është përfunduar sipas ligjit të ri vlerësimi i punëtorëve gjatë kësaj periudhe, deri me 31 janar
- Ka pasur aktivitete me 3 kompanitë e kontraktuar nga Komuna e Rahovecit, në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore edhe pse nuk ka pasur të reshura të bores, kompanitë janë angazhuar në pastrimin e rrugëve nga mbeturinat,
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa ndërhyrje në rregullimin e disa problemeve me ndriçim publik, poashtu ka pasur aktivitete në zgjerimin e ndriçimit publik,
- Kemi angazhuar stafin në bashkërendimin me drejtoritë të tjera në detyrat që janë dhënë në lirim të hapësirave publike dhe inkasimin e mjeteve në shfrytëzimin e këtyre pronave,
- Është bërë ri-marrëveshja e re me KRU Gjakovën,
- Kemi pasur takim me donatorët për zgjerimin e kamerave që përfshin fazën e dytë rrugën tranzite dhe fshatin Hoqë e Madhe, takime me donator Italian për panela solare, takime me donatorin JICA për reformat në menaxhim të mbeturinave,
- Është aprovuar plani për vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera,
- Është aprovuar plani për mobilitet,
- Poashtu ka kaluar edhe plani i transportit rrugor lokal (edhe pse ligjërisht nuk na është kthyer ku ka kaluar me muaj ky dokument),
- Janë sanuar dy segmente rrugore në fshatin Çifllak,
- Kanë filluar punimet në qytet nga kompania e kontraktuar, aktualisht punimet janë duke u zhvilluar në rrugën "Ali Sokoli",
- Kanë filluar punimet në ndërtimin dhe rregullimin e përroskës në fshatin Celine,
- Është bërë propozim rregullorja e re për tarifa dhe për menaxhim të mbeturinave, ka kaluar në proces të diskutimit publik, është aprovuar edhe në kuvendin e komunes,
- Është bërë barazimi i rregullit të hyrave në drejtori,
- Ka filluar ndërtimi i rrugëve në fsh. Hoqë e Vogël, njeri segment është përfunduar, aktualisht jemi duke punuar në rrugën e varrezave të dëshmoreve edhe martireve në fshatin Hoqë e Vogël,
- Ka filluar ndërtimi i dy segmenteve rrugore në fshatin Polluzhë, po vazhdon projekti edhe me 4 segmente në fshatin Pastasel,
- Aktualisht punimet janë duke u zhvilluar në qytet, rrugën "Ali Sokoli", po ashtu sipas planit punimet janë duke vazhduar në rrugën "Shejh Mihedini" nga qendra e qytetit, është kërkuar të rritet dinamika e punimeve ku do të zgjatet deri në ora 23.00 të mbrëmjes,
- Kemi filluar procedurat për instalimin e kamerave të sigurisë në qytet dhe vendet tjera ku është e nevojshme,
- Kane filluar aktivitetet në rrugën 4 korsi, me kompaninë MENDI –P në Lot 3,
- Në bashkëpunim me zyrtarin nga GIS, për mbledhjen e të dhënave për formësimin e hartës së lirisë digjitale si dhe të integruar në platformën Rahoveci Digjital,
- Kemi filluar mbledhjen e të dhënave për energji dhe klimë, është bërë grupi punues për monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave,

- Janë anuluar ne kete periudhe dy kontrata, sipas KVK, këto kontrata janë rishpallur sipas procedurës.

Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2023 do të jenë:

- Sfidat e drejtorisë janë kërkesat e shumëta për ndërtimin e rrugëve lokale si dhe për rrugë dytësore dhe të pa kategorizuara, ka me qindra kërkesa qe po adresohen ne drejtori,
- Sfidë e radhës që vazhdimisht na ka percjellur gjatë ketyre viteve janë mbeturinat e amviserise dhe ato inerte që fatkeqsisht hidhen kudo, vend dhe pa vend ku krijohen deponie ilegale,
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë të shtrirë rrjetin e KRU Gjakovës.

Drejtori i DSHP-së

Përparim Krasniqi

